

LIGJ
Nr.7658, datë 11.1.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN PENAL TË MIRATUAR
ME LIGJIN NR.5591, DATË 15.6.1977

Në mbështetje të nenit 16 dhe 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 109 i Kodit Penal ndryshohet si vijon:

MITA

Marrja e mitës në sajë të detyrës dënohet: me heqje të lirisë nga 3 deri në 10 vjet.

Dhënia e mitës dënohet: me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në 3 vjet.

Mitdhënësi përjashtohet nga përgjegjësia penale kur kallzon vetë veprën e kryer, para fillimit të çështjes penale.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.438, datë 26.1.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha